

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT,
FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

RAPORTI VJETOR 2021

Pasqyra e lëndës

Misioni i AKAFPK-së.....	3
Organizimi.....	Error! Bookmark not defined.
Kontakte	4
AKRONIME.....	5
PËRMBLEDHJE	6
Veprimtaritë kryesore të AKAFPK-së.....	6
Veprimtari në kuadrin e Task Forcës për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve	10
Zbatimi i projektit “EPALE National Support Services 2019-2020” /Erasmus+	10
Marrëveshja e Grantit 614329-EPP-1-2019-1-AL-EPPKA3-AL-AGENDA “National Coordinators for the Implementation of the EU Adult Learning Agenda”, në programin Erasmus+	11
Zbatimi i projektit “FORËORK – Fostering Opportunities of Refugee Ëorkers”, Marrëveshja e Grantit nr. VS/2017/0446, në kuadrin e programit të Bashkimit Europian për punësimin dhe inovacionin social (EASI) ..	11
Veprimtari për rregullimin e praktikave profesionale të nxënësve/kursantëve në biznes	11
Problematikat	12
ANEKSE: VEPRIMTARITË E DETAJUARA SIPAS SEKTORËVE.....	13
ANEKS I Veprimtaria e Sektorit të Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale	13
ANEKS II VEPRIMTARIA E SEKTORIT TË SKELETKURRIKULAVE DHE STANDARDEVE TË TRAJNIMIT TË MËSUESVE NË AFP (SSTM)	20
ANEKS III SEKTORI I VLERËSIM-CERTIFIKIMIT TË NXËNËSVE & AKREDITIMIT TË OFRUESVE TË AFP-së	28
ANEKS IV SEKTORI I ADMINISTRATËS, FINANCËS DHE TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT	35

MISIONI I AKAFPK-SË

AKAFPK-ja ka objekt kryesor të veprimtarisë së saj krijimin e një sistemi unik të kualifikimeve profesionale, të njohura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përmbushje të këtij misioni, Agjencia synon të arrijë objektivat e mëposhtme:

- Zhvillimin e AFP ne lidhje me nevojat e teknologjisë moderne, tregun e punës dhe zhvillimit social te vendit.
- Sigurimin e partneritetit social në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat e planifikimit, zhvillimit dhe zbatimit të programeve të AFP.
- Integrimin e arsimit, formimit dhe punës në këndvështrimin e të nxënit gjatë gjithë jetës.
- Zhvillimin e dimensionit evropian të AFP duke siguruar një transparencë të kualifikimeve dhe përafrimit te kompetencave me tregun e përbashkët evropian.
- Zhvillimin e instrumenteve për realizmin e politikave për zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve
- Hartimin e instrumenteve për zbatimin e sistemit të sigurimit të cilësisë nga institucionet ofruese të AFP-së

Në përmbushje të misionit te saj, AKAFPK-ja kryen funksionet e mëposhtme:

- Harton dhe rishikon Listën Kombëtare të Profesioneve, Listën Kombëtare të Kualifikimeve Profesionale, nivelet dhe standardet përkatëse
- Harton dhe rishikon skelet-kurrikulat e kualifikimeve profesionale;
- Harton dhe rishikon standardet e trajnimit të mësimdhënësve të AFP-së;
- Përcakton parimet dhe kriteret e vlerësimit dhe certifikimit për kualifikimet profesionale;
- Akrediton institucionet e AFP për kualifikimet profesionale;
- Siguron që standardet e kompetencave të jenë në përputhje të plotë më praktikat më të mira ndërkombëtare, në veçanti me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve dhe Sistemin Evropian të Krediteve për AFP-në;
- Siguron bashkëveprimin e të gjithë aktorëve kontribuues të shoqërisë, në të gjitha nivelet dhe fazat e planifikimit, zhvillimit dhe zbatimit të programeve të AFP-së.

KONTAKTE

Ejvis Gishti
Drejtore i AKAFPK-së Tel: 042230497
Email: Ejvis.Gishti@akafp.gov.al

Alqi Mustafai
Përgjegjës i Sektorit të Skelet-Kurrikulave dhe Standardeve të Trajnimit të Mësuesve të AFP-së
Tel: 042237087
Email: Alqi.Mustafai@akafp.gov.al

Teuta Braço
Përgjegjëse e Sektorit të Administratës, Financës dhe Teknologjisë së Informacionit
Tel: 042237087
Email: Teuta.Braco@akafp.gov.al

AKRONIME

AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional
AKAFP	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
AKP	Agjencia Kombëtare e Provimeve
ETF	European Training Foundation (Fondacioni Evropian i Trajnimeve)
DRFPP	Drejtori Rajonale e Formimit Profesional Publik
ISCED	International Standard for Classification in Education (Standardi Ndërkombëtar për Klasifikim në Arsim)
ILO	International Labor Organisation (Organizata Ndërkombëtare e Punës)
IoAFP	Institucione Ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Para-universitar
LKP	Lista Kombëtare e Profesioneve
KEK	Korniza Evropiane e Kualifikimeve
KShK	Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
SAFTI	Spektori i Administratës, Financës dhe Teknologjisë së Informacionit
SPKP	Spektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale
SSTM	Spektori i Skeletkurrikulave dhe Standardeve të Trajnimit të Mësuesve
SVCA	Spektori i Vlerësim-Certifikimit dhe Akreditimit të Ofruesve të AFP-së

PËRMBLEDHJE

Veprimtaritë kryesore të AKAFPK-së

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve ka zbatuar veprimtaritë në përputhje me planin vjetor të punës të miratuar në vitin 2020 nga drejtori.

Veprimtaritë e AKAFPK-së janë zhvilluar në përputhje me prioritetet e zhvillimit të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, prioritetet të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022, në objektivat e përcaktuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për rritjen e cilësisë në AFP, në parashikimet e PBA-së, si dhe në përshatje më kushte e situatës së jashtëzakonshme të krijuar nga COVID 19.

Sipas këtij plani, AKAFPK e fokusoi punën në këto prioritetet kryesore:

- Publikimi dhe këshillimi i Listës Kombëtare e Profesioneve (LKP);
- Zhvillimi i analizave të punës dhe hartimi i standardeve të profesioneve;
- Zbatimi dhe zhvillimi i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve në sektorin e AFP-së
- Hartimi i përshkrimeve të kualifikimeve për nivelet 2- 5 të KShK-së
- Hartimi i skeletkurikulave për kualifikimet profesionale të niveleve 2-5 të KShK-së;
- Hartimi i materialeve mësimore mbështetëse për mësues e nxënës të arsimit të mesëm profesional në zbatim të skeletkurikulave;
- Hartimi i programeve orientuese për provimet e niveleve të arsimit të mesëm profesional si dhe hartimi i programeve orientuese për maturën shtetërore profesionale;
- Hartimi i bankave të testeve si instrument mbështetës për mësuesin në hartimin e provimeve të niveleve të arsimit të mesëm profesional;
- Mbështetja e shkollave profesionale për zhvillimin e mësimin dhe vlerësimin në kushtet e shtëpisë, për lëndët profesionale dhe modulet profesionale në arsimin profesional në kushtet e pandemisë.
- Sigurimi i cilësisë në AFP.

Gjatë këtij viti, AKAFPK ka koordinuar veprimtarinë me MFE-në dhe Agjencinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi për të lehtësuar përdorimin e Listës Kombëtare të Profesioneve të përditësuar, miratuar me VKM nr. 514, datë 20.09.2017. Gjithashtu, është ofruar këshillim dhe orientim për të interpretuar rubrika të LKP sipas kërkesës së përdoruesve të ndryshëm duke lehtësuar aksesin për të gjithë përdoruesit.

Në kuadrin koordinimit të punës për ngritjen e Komiteteve sektoriale, me mbështetjen e RISI Albania, është miratuar urdhri për ngritjen e komitetit sektorial të TIK si dhe janë zhvilluar

kapacitetet e sekretariatit teknik në AKAFPK. Gjithashtu, gjatë këtij viti është zhvilluar metodologjia për delimitimin e sektorit TIK.

Gjatë këtij viti, janë përshtatur 11 përshkrime profesionale si bazë për hartimin e kurseve afatshkurta dhe janë finalizuar 20 standarde profesionale, nga të cilat 4 janë standarde rajonale profesionale për Ballkanin Perëndimor. Gjithashtu, 21 përshkrime të kualifikimeve profesionale të niveleve 2-5 të KShK-së janë zhvilluar, lista e detajuar e të cilave gjendet në anekset e këtij raporti.

Në kuadrin e përshtatjes së skeletkurrikulave të AP me kërkesat e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, Sektori i ka rishikuar të gjitha skeletkurrikulat (118 skeletkurrikula) e kualifikimeve profesionale të AP dhe i ka publikuar në një format të ri në faqen e internetit të AKAFPK.

Gjatë 2021 janë hartuar, rishikuar dhe përmirësuar të 21 skeletkurrikulave për vitet shkollore 2021-22 dhe 2022-23, si dhe janë rishikuar 2 programe të lëndëve profesionale.

Gjithashtu janë hartuar 10 programeve për Kurset e unifikuara të Formimit profesional publik (Lista e detajuar gjendet në anekset e këtij raporti).

Gjatë vitit 2021, janë kryer edhe produrat e duhura dhe është mundësuar transferimi i 5 nxënësve, nga shkollat profesionale jashtë vendit, në shkollat profesionale të vendit tonë.

Janë hartuar 25 materiale mësimore mbështetëse të lëndëve profesionale të AP. Me mbështetjen e Save the Children, është rishikuar edhe materiali mësimor mbështetës për lëndën “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13. Gjithashtu, janë përgatitur programet sintetike të zbatuara në shkollat profesionale para vitit 2008 dhe ka plotësuar kërkesat për 90 aplikues, për të tilla programe.

Gjatë vitit 2021, AKAFPK ka mbikëqyrur zbatimin e produkteve kurrikulare në SHP-të dhe DRFPP-të, si dhe ka udhëzuar e këshilluar drejtuesit dhe mësuesit/instruktorët në lidhje me to. Kjo mbështetje është kryer si nëpërmjet kontakteve dhe takimeve të drejtpërdrejta (gjatë takimeve në AKAFPK dhe vizitave në shkolla profesionale dhe DRFPP) ashtu edhe nëpërmjet komunikimeve në distancë dhe online (e-mail, biseda telefonike, ëëbinare). Informacione me vlerë janë marrë edhe gjatë trajnimeve didaktike dhe për aspekte të tjera, të dhjetra mësuesve dhe drejtuesve të shkollave profesionale dhe DRFPP-ve. Janë bërë propozime konkrete për ndryshimet e nevojshme në sistemin e zhvillimit të vazhduar profesional të mësimeve në AFP, duke qenë pjesë aktive e ndryshimeve ligjore për institucionalizimin dhe mbështetjen e “njësive të zhvillimit” në ofruesit e AFP.

Në kuadër të fillimit të vitit shkollor 2021-22, është përgatitur dhe publikuar “Udhëzuesi për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale” me informacione mjaft të dobishme për

aspektet kurrikulare, të mësimdhënies, të vlerësimit të nxënësve, të organizimit orarit të shkollave, të orientimit të tyre nga kërkesat e tregut rajonal të punës etj.

Në kuadrin e përhapjes së pandemisë COVID 19 dhe të kalimit të mësimin pjesërisht dhe plotësisht online në periudha të caktuara të vitit 2021, është përgatitur një *Udhëzues për mësimin dhe vlerësimin në kushtet e shtëpisë* për shkollat profesionale dhe më pas, është realizuar një *analizë* e hollësishme me mbështetjen e S4J nëpërmjet një pyetësori (online). Raporti në lidhje me ecurinë dhe problematikat e zbatimit të mësimin në kushtet e shtëpisë është publikuar në faqen e internetit të AKAFPK-së.

Edhe gjatë vitit 2021, Sektori i SSTM dhe Drejtoria e ZHPO janë angazhuar në zbatimin e Programit të Trajnimit 24 ditor për “*Bazat e didaktikës në AFP*” për 5 grupe (rreth 100 mësimdhënës), të rajoneve të Tiranës, Elbasanit dhe Durrësit, të mbështetur nga GIZ dhe Save the Children. Tre pjestarë të Sektorit kanë kontribuar drejtpërdrejt jo vetëm në koordinimin dhe harmonizimin e zbatimit të këtij programi, por edhe në trajnimin e drejtpërdrejtë të këtyre 5 grupeve të mësimdhënësve.

Anëtarët e Sektorit të SSTM dhe Drejtorisë së ZHPO janë angazhuar edhe si trajnerë në hartimin e programeve të trajnimit dhe në moderimin e seancave të trajnimeve (me prezencë fizike dhe online), si më poshtë:

- Për rreth 50 mësues të lëndës “Bazat e sipërmarrjes” (mbështetur nga Save the Children).
- Për rreth 25 Koordinatorë të Marrëdhënieve me Biznesin (mbështetur nga OeAD).
- Për rreth 40 Koordinatorë të Zhvillimit të Vazhduar Profesional (mbështetur nga S4J).
- Për rreth 40 Koordinatorë të Kurrikulave (mbështetur nga S4J).

Në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Para universitar, Sektori ka mbështetur edhe hartimin e Programit Kombëtar të Kualifikimit, si dhe përgatitjen e testeve përkatëse për kualifikimin (atestimin) e mësuesve dhe instruktorëve të kulturës profesionale në AP, për vitin 2021.

Gjatë këtij viti, janë hartuar 5 programe orientuese, si dhe janë rishikuar 26 programeve orientuese për provimet përfundimtare të niveleve.

Gjithashtu, është pasuruar dhe regjistri për të gjithë ofruesit, me të dhëna si numri i nxënësve që ofrohen në kualifikimet profesionale përkatëse në të gjithë sistemin tonë të Arsimit Profesional

Janë hartuar 4 programe të reja orientuese të Maturës Shtetërore Profesionale dhe u rishikuan 10 programe orientuese të Maturës Shtetërore Profesionale. Ndërkohë, u plotësuan 38 programe orientuese të Maturës Shtetërore Profesionale me referencat e bazës ligjore (Udhëzuesi i përbashkët MAS-MFE dhe Rregullorja e Maturës Shtetërore 2021).

Gjithashtu, janë hartuar 1100 njësi të testit në përputhje me planin vjetor për këtë qëllim, duke plotësuar nevojën për to në kualifikimet profesionale. Janë hartuar dhe rishikuar suplementet e certifikatave profesionale për 26 drejtimet/profilet në arsim profesional.

Gjatë këtij viti i gjithë procesi i vetëvlerësimit të ofruesve të AFP-së, u zhvillua sipas një kalendari të miratuar nga AKAFPK-ja

Për periudhën në të cilën u zhvillua procesi i vetëvlerësimit, për vitin shkollor 2019-2020, në nivel kombëtar pati vlerën 1.8

Në vijim, për vitin shkollor 2021-2022 procesi i vetëvlerësimit do të kryhet mbështetur në udhëzimin nr. 18, datë 6.7.2021 për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 16, datë 8.5.2018, “për zhvillimin e vetëvlerësimit në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional”, ku të gjithë IoAFP-të do të vlerësojnë të pesë fushat e cilësisë. Për këtë, është hartuar dhe shpërndarë Kalendari i zbatimit të procesit të vetëvlerësimit në institucionet ofruese të AFP-së.

AKAFPK-ja, në bashkëpunim me UNDP-në, Programi “Zhvillimi i Aftësive për Punësim” ka zhvilluar për herë të parë tashmë, me një ekspertizë ndërkombëtare, një model të plotë të procesit të Akreditimit, për Institucionet ofruese të AFP-së.

Në mbështetje të këtij procesi janë zhvilluar veprimtari dhe dokumente si më poshtë:

- Konsolidimi i bazës ligjore, urdhri nr. 128, datë 6. 7. 2021 për miratimin e rregullores “për standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional”
- Hartimi i procedurave, dokumenteve dhe formularëve të standardizuar të akreditimit.
- Udhërrëfytyesi për procesin e akreditimit. Në këtë kuadër u zhvillua modeli i parë i sistemit të akreditimit, me standardet, procedurat, instrumentet dhe udhëzimet e zbatimit të procesit.
- Rekrutimi, përzgjedhja dhe trajnimi i vlerësuesve të jashtëm dhe trajnimi i ekspertëve të brendshëm të AKAFPK-së. Ky program trajnimi u zhvillua në dy grupe, në total 40 kandidatë vlerësues të jashtëm dhe 4 specialistë të AKAFPK-së. U pajisën me certifikatë 17 vlerësues nga grupi i parë i vlerësuesve të jashtëm për akreditimin e ofruesve të arsimit dhe formimit profesional i cili u zhvillua gjatë periudhës qershor-dhjetor 2021, në total 10 ditë/60 orë trajnimi (36 orë teori dhe 24 orë praktikë). Po vijon procesi i vlerësimit të grupit të dytë të kandidatëve për vlerësues të jashtëm të IoAFP-ve.
- Realizimi i pilotimit të procesit të akreditimit, bazuar në gatishmërinë e ofruesit për akreditim. Në këtë proces u përfshinë 5 institucione ofruese të arsimit profesional, ku u përzgjodhën 6 kualifikime profesionale nga oferta e tyre arsimore.

Në profilin e një institucioni qendror përgjegjës për sigurimin e cilësisë në AFP, AKAFPK është angazhuar në Forumin për Sigurimin e Cilësisë në AFP të lançuar nga ETF në nëntor 2017. Gjithashtu, AKAFPK merr pjesë me një anëtar të nominuar nga qeveria shqiptare në Bordin Këshillimor të KEK.

Përpos veprimtarive të bazuara në funksionet thelbësore të saj, AKAFPK ka zbatuar disa projekte të financuara nga programi Erasmus+ i BE-së, si dhe veprimtari të tjera edhe sipas prioriteve në Strategjinë Kombëtare për Aftësi dhe Punësim 2019-2022.

Veprimtari në kuadrin e Task Forcës për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve

AKAFPK është angazhuar në Task Forcën e KShK-së për zhvillimin dhe zbatimin e mëtejshëm të KSHK-së, mandati i së cilës është rinovuar për 2 vite të tjera në janar 2020. Gjatë këtij viti, Task Force ka ri-aktivizuar grupe teknike përkatëse të ngritura me qëllim zbatimin e procesit të referencimit. Në këto grupe marrin pjesë përfaqësues/ekspertë të fushës së arsimit të lartë, arsimit para universitar të përgjithshëm dhe arsimit dhe formimit profesional, nga drejtoria e përgjithshme e politikave dhe programeve të zhvillimit në MASR, drejtoria e integritit, marrëveshjeve dhe asistencës në MASR, ASCAP, QSHA, ASCAL, AKAFPK, drejtoria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional në MFE dhe përfaqësues të institucioneve ofruese, shoqatave të biznesit, sindikatave, etj. U përgatit raporti i referencimit të KSHK me KE me përfshirjen e të gjithë aktorëve relevantë si dhe të dy eksperteve nderkombëtare respektivisht për AFP dhe arsimin e lartë. Raporti i referencimit u prezantua nga Znj. Ejvis Gishti në Bordin Këshillimor të KEK. Bordi Këshillimor i KEK vlerësoi arritjet në zhvillimin dhe zbatimin e KSHK dhe pranoi referencimin e KSHK me KEK në tetor 2021.

Zbatimi i projektit “EPALE National Support Services 2019-2022” /Erasmus+

Si qendër kombëtare mbështetëse e emëruar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, AKAFPK ka nënshkruar Marrëveshjen e Grantit për promovimin e Platformës Elektronike për të Nxënërit e të Rriturve në Evropë (EPALE) në periudhën 2019-2022. Në zbatim të planit të punës së këtij projekti, janë organizuar takime me institucione ofruese, politikë bërës dhe organizata në fushën e të nxënërit të të rriturve. Në vijim janë organizuar tre takime rajonale të zhvilluara në Shkoder, Kamëz, etj. si dhe java e të nxënërit gjatë gjithë jetës në Gjirokastr dhe Korçë. Ndërkohë që për shkak të situatës së krijuar nga COVID 19, disa takime të planifikuara u shtynë për vitin 2022.

Takimet rajonale janë zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional, me përfaqësues të pushtetit lokal, bashki dhe prefektura, drejtori arsimore, universitete, si dhe aktorë të tjerë që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në kuadrin e arsimit të të rriturve.

Pjesëmarrësit ishin aktivë dhe të interesuar të njiheshin me Platformën EPALË si dhe prioritetet dhe zhvillimet në sektorin e të nxënërit të të rriturve. Për promovimin e Platformës EPALË, takime informuese janë zhvilluar edhe në kuadrin e veprimtarive të organizuara nga partnerët të të tjerë, si p.sh në kuadrin e javës së aftësive të zhvilluar në Tiranë, etj.

Gjithashtu, në zbatim të këtij projekti janë publikuar në këtë platformë elektronike, si dhe në rrjetet sociale artikuj, lajme, studime mbi të nxënit e të rriturve, sipas indikatorëve të përcaktuar nga donatori.

Lidhur me menaxhimin teknik e financiar të këtij projekti, AKAFPK raporton periodikisht Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Marrëveshja e Grantit 614329-EPP-1-2019-1-AL-EPPKA3-AL-AGENDA “National Coordinators for the Implementation of the EU Adult Learning Agenda”, në programin Erasmus+

Gjatë këtij viti, ka vijuar zbatimi i projektit për mbështetjen e njësisve zhvillimore në Ofruesit e AFP-së për zhvillimin e rolit të orientimit për karriere. Është zhvilluar një studim për qasjen e orientimit dhe zhvillimit për karrierë në vendin tonë sid e modelet bashkëkohore në këtë drejtim. Është zhvilluar një program trajnimi për koordinatorët e orientimit për karrierë ne ofruesit e AFP-së dhe janë trajnuar 15 persona.

Zbatimi i projektit “FORWORK – Fostering Opportunities of Refugee Workers”, Marrëveshja e Grantit nr. VS/2017/0446, në kuadrin e programit të Bashkimit European për punësimin dhe inovacionin social (EASI)

Në kuadrin e zbatimit të projektit “FORWORK – Fostering Opportunities of Refugee Workers”, me Marrëveshjen e Grantit nr. VS/2017/0446, programi i Bashkimit European për punësimin dhe inovacionin social (EASI), Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit për arritjen e qëllimit kryesor të projektit për të zhvilluar një plan individual të integritit për azilkërkuesit në vend, ka zhvilluar takime koordinuese ne bashkëpunim me Adriapol, me Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe aktorë të tjerë të tillë si UNICEF, UNHCR IOM, etj. me qëllim grumbullimin e informacionit të nevojshëm për të identifikuar grupin e synuar, si dhe për të krijuar ura bashkëpunimi për të vepruar në përputhje me politikat dhe praktikën ekzistuese në Shqipëri. Për shkak të situatës së krijuar nga COVID, projekti kaloi në një proces amendimi. Eshtë zhvilluar online kursi për ndihmes kuzhinier për 30 Azilkërkues. Zbatimi i procesit mësimor është koordinuar nga partneri tjetër lokal, ADRIAPOL. AKAFPK ka hartuar raportin teknik dhe financiar për mbylljen e projektit.

Veprimtari për rregullimin e praktikave profesionale të nxënësve/kursantëve në biznes

Rregullorja për praktikën profesionale të nxënësve në biznes u miratua në shtator të këtij viti. Ndërkohë me mbështetjen e OEAD, u ndërmorr një anketim për situatën e zbatimit të rregullores së praktikave profesionale, si dhe u organizuan 4 takime konsultative rajonale me bizneset partnere në Tiranë, Durrës, Korçë, Lushnjë dhe Shkodër, me qëllim për të prezantuar

modalitetet e zbatimit të rregullores për praktikat profesionale në biznes dhe efektet e tyre në cilësinë e mësimdhënies dhe mbarëvajtjen e marëdhënies shkollë-biznes.

Problematikat

Miratimi i strukturës dhe organikës së propozuar nga AKAFPK do të mbështesë modernizimin e KSHK-së rritjen e zbatueshmërisë së saj në kuadrin e përafrimit të këtij kuadri ligjor me rekomandimet e Këshillit Evropian të 22 majit 2017 për *“Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për të nxënëit gjatë gjithë jetës”* (2017 / C 189/03), si dhe zhvillimin cilësor të ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional me ngritjen e sistemit të kualifikimit të vazhduar të personelit mësimdhënës në AFP. Sfide mbetet plotësimi me prioritet i vendeve të lira ne organike.

Gjithashtu, Situata e krijuara nga COVID 19 ka krijuar vështirësi në koordinimin e veprimtarive përkatëse dhe ka ridimensionuar veprimtaritë e institucionit duke i dhënë prioritet mbarëvajtjes së zhvillimit të procesit mësimor në kushtet e shtëpisë.

ANEKSE: VEPRIMTARITË E DETAJUARA SIPAS SEKTORËVE

ANEKS I VEPRIMTARIA E SEKTORIT TË PROFESIONEVE DHE KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE

Veprimtari lidhur me Profesionet

AKAFPK ka koordinuar veprimtarinë me MFE-në për të lehtësuar përdorimin e Listës Kombëtare të Profesioneve të përditësuar, miratuar me VKM nr. 514, datë 20.09.2017. Gjithashtu, është ofruar këshillim dhe orientim për të interpretuar rubrika të LKP sipas kërkesës së përdoruesve të ndryshëm duke lehtësuar aksesin për të gjithë përdoruesit.

Në kuadrin koordinimit të punës për ngritjen e Komiteteve Sektoriale, me mbështetjen e RISI Albania, është zhvilluar një Rregullore e Sekretariatit Teknik të Komiteteve Sektoriale, Rregullore e brendshme për procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të komiteteve sektoriale, (kompetencë e AKAFPK), Urdhri për miratimin e rregullores së funksionimit të sekretariatit teknik të komiteteve sektoriale, urdhra dhe njoftime të ndryshme për funksionimin e Komiteteve Sektoriale.

Ehte krijuar komiteti sektorial TIK me urdhrin e përbashkët të MFE-së dhe MASR, Nr. 64, datë 30.03.2021.

Është miratuar dhe VKM për shpërblimin e anëtarëve të Komitetit sektorial me Nr. 322, date 02.06.2021 “Për një shtesë në vendimin nr. 656, datë 31.10.2018, “Për përcaktimin e masës së shpërbimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njëjësive të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar.

AKAFPK, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, ka ngritur Sekretariatit Teknik të Komiteteve Sektoriale për mbështetjen e aktivitetit të Komiteteve Sektoriale.

Gajtë dhjetorit është ndjekur procedura për përzgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Sektoriale TIK, kompetencë e AKAFPK.

Gjatë vitit 2021, janë përshtatur 11 përshtime profesionale, si bazë për hartimin e kurseve afatshkurta dhe janë finalizuar 20 standarde profesionale, nga të cilat 1 është standard rajonal profesional për Ballkanin Perëndimor. Gjithashtu, janë zhvilluar 21 standarde të kualifikimeve profesionale të niveleve 2-4 të KShK-së, lista e detajuar e të cilave gjendet në anekset e këtij raporti.

Baza ligjore ekzistuese në arsim dhe formim profesional përcakton domosdoshmërinë e rishikimit institucional dhe nevojën e zgjerimit të gamës së funksioneve në përgjigje të prioriteteve për zhvillimin e sistemit të kualifikimeve profesionale, veçanërisht të zhvillimit dhe zbatimit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) dhe të rritjes së efektivitetit dhe eficiencës së ofruesve të arsimit dhe formimit profesional. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 426, datë 26.6.2019 “Për mënyrën e organizimit, të funksionimit, si dhe kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të komiteteve sektoriale dhe mënyrën e shpërblimit të tyre” është miratuar dhe VKM për shpërblimin e anëtarëve të Komitetit sektorial.

Gjithashtu, Situata e krijuar nga COVID 19 ka krijuar vështirësi në koordinimin e veprimtarive përkatëse.

VEPRIMTARIA E DREJTORISË SË PROFESIONEVE DHE KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE

Veprimtari lidhur me Profesionet

Edhe gjatë këtij viti, fokusi i veprimtarisë së sektorit në kuadrin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP) ka qenë mbështetja e përdoruesve të saj. Sektori ka mbështetur dhe orientuar përdorues të ndryshëm përmes materialeve informuese të LKP në format tekst dhe në format elektronik. Janë zhvilluar takime orientuese me subjekte të interesuara për përdorimin dhe interpretimin e informacionit të LKP. Janë zhvilluar takime në rajone të ndryshme kryesisht në institucionet ofruese të AFP-së dhe me bizneset, për të promovuar LKP dhe lehtësuar përdorimin e saj me qëllim të orientimit më të mirë në tregun e punës.

Në mbështetje të procesit të zhvillimit të kurrikulës për kurse afatshkurtra të unifikuara është identifikuar nevoja për këto kurse në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, si dhe është përshtatur informacioni i 11 përshkrimeve të profesioneve. Këto të dhëna mbi profesionet kanë shërbyer si dokument bazë për hartimin e kurrikulave për kurset afatshkurtra të unifikuara.

Gjithashtu janë hartuar dhe validuar 20 standarde profesionale me përfaqësues të bizneseve dhe mësimdhënësve të AFP ku 10 nga të cilët janë zhvilluar me mbështetje e projektit “Skills for jobs”.

Veprimtari lidhur me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve

II.1. Katalogu Kombëtar e Kualifikimeve Profesionale

Janë zhvilluar vizita në shkolla profesionale në Tiranë, Kamëz, Durrës, Golem, Kavajë, Lezhë, Shkodër, Rubik, Kukës, Peshkopi, Bulqizë, Elbasan, Cërrik, Korçë, Lushnje, Berat, Fier, Vlorë, Sarandë dhe Gjirokastrë, me qëllim të përditësimit të Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale sipas nevojave të tregut por edhe të ndërgjegjësimit të ofruesve lidhur me llojshmërinë kualifikimeve pjesë e tij, për të diversifikuar portofolin e kualifikimeve sipas nevojave të rajonit.

Me Urdhër nr. 99 datë 25.5.2021 të MFE, “Për miratimin e Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale” është miratuar katalogu Kombëtar i Kualifikimeve profesionale për nivelet 2-5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve i cili përfshin emërtimin e kualifikimeve profesionale, nivelin përkatës në KSHK, volumin e të nxënit, kohëzgjatjen e periudhës së miratimit, si dhe anekse të dokumenteve zhvillimore që shoqërojnë çdo kualifikim profesional, standardet (përshkruesit) përkatëse për secilin kualifikim në lidhje me njohuritë, aftësitë dhe kompetencat, të bazuara në rezultate të nxënit.

Gjatë vitit 2021 janë zhvilluar vizita në Shkollat profesionale dhe kompani biznesi, me mbështetjen e projektit “Skills for Jobs” Qëllimi i këtyre vizitave ishte:

- Mbledhja e informacioneve për ecurinë e kualifikimeve dhe problematikave të hasura gjatë procesit të ofrimit të tyre
- Identifikimi i nevojave të reja të kualifikimeve
- Orientimi i ofruesit në zgjedhjen e kualifikimeve nga lista përkatëse sipas tendencave të tregut të punës në rajon.
- Informimi i bizneseve lidhur me kualifikimet e ofruara nga shkollat profesionale, si dhe identifikimi i nevojave për kualifikime në fusha të ndryshme të aktivitetit të tyre.

II.2. Standardet e kualifikimeve profesionale

Gjatë këtij viti, janë hartuar 21 standarde e kualifikimeve profesionale të niveleve 2, 3 dhe 4 të KShK-së janë zhvilluar, në terma të rezultateve të nxënit për njohuritë, shprehitë profesionale dhe kompetencat më të përgjithshme në përputhje më përshkruesit e niveleve të KSHK-së dhe mbështetur në standardet e profesioneve përkatëse. Në këtë proces janë angazhuar mbi 100 bashkëpunëtorë duke përfshirë përfaqësues të bizneseve të ndryshme, por edhe mësues të shkollave profesionale. Lista e detajuar e standardeve të kualifikimeve profesionale është në aneksin I.

II/3. Veprimtari në kuadrin e Task Forcës për KSHK dhe anëtarësimit në Grupin Këshillimor të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK)

AKAFPK është angazhuar në Task Forcën e KShK-së për modernizimin e kuadrit ligjor për KSHK-në dhe në vijim të punës për plotësimin e kuadrit ligjor në mbështetje të ligjit Nr. 23/2018 “Për disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin Nr. 10 247, Datë 4.3.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve. Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është punuar për propozim për ndryshim të aktin nënligjor për shpërblimit e anëtarëve të komitetit sektorial, si dhe përgatitjen e Urdhrit të Përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për ngritjen e komitetit të parë sektorial..

Në kuadrin e veprimtarisë së Task Forcës për KSHK, është kontribuar në të gjitha takimet e zhvilluara gjatë këtij viti, me prezantime, informacione, komente dhe sugjerime për çështje të ndryshme që lidhen me KSHK.

Me mbështetjen e RISI Albania, në kuadrin e pilotimit të komitetit sektorial në sektorin e TIK, janë ndjekur procedurat për miratimin e urdhrit të përbashkët të dy ministrave të Financave dhe Ekonomisë dhe të arsimit dhe Sporteve për ngritjen e komitetit sektorial të TIK.

AKAFPK është angazhuar në Task Forcën e KShK-së për zhvillimin dhe zbatimin e mëtejshëm të KSHK-së, mandati i së cilës është rinovuar për 2 vite të tjera në janar 2020. Gjatë këtij viti, Task Force ka ri-aktivizuar grupe teknike përkatëse të ngritura me qëllim zbatimin e procesit të referencimit. Në këto grupe marrin pjesë përfaqësues/ekspertë të fushës së arsimit të lartë, arsimit para universitar të përgjithshëm dhe arsimit dhe formimit profesional, nga drejtoria e përgjithshme e politikave dhe programeve të zhvillimit në MASR, drejtoria e integritit, marrëveshjeve dhe asistencës në MASR, ASCAP, QSHA, ASCAL, AKAFPK, drejtoria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional në MFE dhe përfaqësues të institucioneve ofruese, shoqatave të biznesit, sindikatave, etj. U përgatit raporti i referencimit të KSHK me KE me përfshirjen e të gjithë aktorëve relevantë si dhe të dy eksperteve nderkombëtare respektivisht për AFP dhe arsimin e lartë. Raporti i referencimit u prezantua nga Znj. Ejvis Gishti në Bordin Këshillimor të KEK. Bordi Këshillimor i KEK vlerësoi arritjet në zhvillimin dhe zbatimin e KSHK dhe pranoi referencimin e KSHK me KEK në tetor 2021.

IV. Veprimtari në kuadër të zbatimit të projekteve për “Platformën elektronike të të nxënit të të rriturve” (EPALE), AL-AGENDA

Në kuadrin e projektit EPALE dhe AL-AGENDA është kontribuar në takimet e organizuara në kuadrin e Projektit EPALE, si dhe në vlerësimin e kandidatëve për ekspertë në kuadrin e projektit. Gjithashtu, është kontribuar me informacione përmbajtjesore (Blog) në platformë për evente të ndryshme në AFP.

V. Bashkëpunim me MFE dhe institucione të tjera

Në kuadrin e hartimit të akteve nënligjore në mbështetje të ligjit nr. 15/2017 datë 16.2.2017 për AFP-në, është kontribuar me komente, sugjerime për draft-aktet nënligjore përkatëse, si dhe në hartimin e draft urdhrit për miratimin e Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale i cili

u miratua në prill 2021.. Gjithashtu, është dhënë kontribut për plotësimin e fishave për raport progresin SKAP 2019-2022. AKAFPK është kontribuese e rëndësishme në Kapitullin 26, por edhe në kapitujt 2, 3 për përafrimin e legjislacionit me *Acquis e BE*.

Përfaqësues të sektorit kanë marrë pjesë në takime të ndryshme të organizuara nga institucione të ndryshme, të tilla si:

- Kontribut në grupin e punës për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit për KSHK.
- Pjesëmarrje në takimet për Këshillim dhe Diskutim për Kapitullin 2 “Liria e lëvizjes së Punëtorëve”, për kapitullin 3 “E drejta e vendosjes dhe liria e ofrimit të shërbimeve”, nëngrupi për “Profesionet e rregulluara”, të organizuara nga MEPJ, MFE dhe MASR
- Pjesëmarrje në konferencën mbi prezantimin Publik të rezultateve të Studimit të Fizibilitetit për Zhvillimin e Standardeve të Kualifikimeve të Bazuar Rajonale i organizuar online, Prill 2021 nga ERI SEE
- Koordinimi dhe organizimi i konferencës përmblyëse të projektit TO REGOS, Qershor 2021 organizuar në Tiranë.
- Pjesëmarrje në takimin online, organizuar nga ETF me temë "Matja e Mospërputhjeve të Aftësive – Rasti i Shqipërisë" qershor 2021.
- Pjesëmarrje në takimin e nëntë të menaxhimit të projektit (PMM) organizuar në Mal të Zi, në kuadër të projektit - TO REGOS, qershor 2021, financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim.
- Pjesëmarrje në takimin organizativ dhe të zhvillimit të kapaciteteve organizuar në kuadër të projektit - TO REGOS, në Budva, Mal të Zi, Korrik 2021.
- Pjesëmarrje online në seminarin kombëtar me temë: “Referencimi i Kornizës Shqiptare të Kualifikimit në Kornizën Evropiane të Kualifikimit (KEK) dhe vetë-referencimi në kornizën e kualifikimit të EHEA (QF-EHEA)”. organizuar nga Zyra Kombëtare Erasmus+ në bashkëpunim me grupin e Ekspertëve të Reformës së Arsimit të Lartë - HERE, Shtator 2021.
- Pjesëmarrje në ëorkshopin mbi VET-MIS me temë “Prezantimi i gjetjeve në lidhje me sistemet ekzistuese të TI në AFP dhe diskutimi mbi opsionet e mundshme për SMI të AFP-së të planifikuar. organizuar nga projekti “Technical Assistance to Support the Reform on Employment Policies and Vocational Education and Training”, Tetor 2021,
- Pjesëmarrje në takimin online të ETF-së me temë: “Inovacioni dhe përshtatja e politikave aktive të tregut të punës për ndryshimin e kushteve ekonomike e sociale” Tetor 2021.
- Pjesëmarrje në ëorkshopin dy ditor mbi prioritetet, monitorimi dhe vlerësimi i Programit të ri të ILO-s për Punën e Denjë për Shqipërinë 2022-2026 (17 – 18 Nëntor 2021), organizuar nga zyra e ILO-s në Budapest.
- Pjesëmarrje në një fokus grup me stafin e "njësive të zhvillimit" të shkollave të mesme që ofrojnë drejtimin “Bujqësi” dhe “Veterinari” me synimin e një eksplorimi cilësor mbi nevojën për aftësi të reja profesionale në përputhje me nevojat e biznesit organizuar me mbështetjen e konsorciumit “PEMA” (Progetto Emilia-Romagna per l’Albania) për rishikimet kurrikulare.

- Pjesëmarrje në takimin online dypalësh mbi “ Youth Guarantee” midis Shqipërisë dhe BE-së (Komisioni Evropian, Delegacioni i BE-së dhe ETF) dhe Organizatës Ndërkombëtare të Punës.
- Pjesëmarrje në takimin e parë të menaxhimit të projektit për komponentin e AFP-së “Rritja e cilësisë së arsimit dhe trajnimit në vendet e Evropës Juglindore – projekti EQET. Projekti financohet nga Agjencia Austriake për Zhvillim me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim dhe do të zbatohet nga Iniciativa për Reformën Arsimore të Evropës Juglindore (ERI SEE).

SPKP – Lista e Produkteve 2021

Produkte që lidhen me profesionet

I. Analizat e profesionit të përshtatura nga LKP për zhvillimin e kurseve afatshkurtra

1. “Punime ndërtimi”
2. “Automekanik”
3. “Punime druri”
4. “Përpunim mishi”
5. “Termohidraulikë”
6. “Prodhime brumi”
7. “Shërbime udhëtimi”
8. “Shërbime kondicionerësh”
9. “Përpunim qumështi”
10. “Përpunim fruta perime”
11. “Mekanikë bujqësore”

II. Standarde profesioni të finalizuara

1. Teknik rrjetesh
2. Teknik për mbështetje e përdoruesve të TIK
3. Teknik ëbsite
4. Ndihmës teknolog ushqimore
5. Ndihmës në Ekonomi-biznes
6. Teknik në Multimedia
7. Asistent zyre
8. Teknik Mekatronik
9. Ndihmës në elektroteknikë
10. Hidraulik
11. Instalues të sisteme të ftohje –ngrohje

12. Elektracist
13. Veteriner i mesëm/Teknik veteriner
14. Peshkatar i kualifikuar
15. Elektracist i linjave të TU dhe TL
16. Teknik elektrik
17. Asistentë, specialistë të punës sociale
18. Teknik gjeodet
19. Murator dhe Suvatues
20. Ndhmës në Hoteleri-turizëm

Produkte që lidhen me fushën e kualifikimeve profesionale

1. Lista e standardeve të kualifikimeve

1. T1-IV-21-Rrjete të dhënash
2. T2-IV-21-Mbështetje e përdoruesve të TIK
3. T3-IV-21-Zhvillim ëbsite
4. T4-IV-21-Programim
5. E-IV-21-Elektroteknikë
6. B2-III-21-Shtrim dhe veshje me pllaka
7. A-II-21- Teknologji ushqimore
8. L-II-21 -Ekonomi-biznes
9. E8-IV-21- Mekatronikë
10. L7-IV-21-Administrim zyre
11. V1-III-21-Instalime hidraulike
12. T5-IV-21-Multimedia
13. E-II-21-Elektroteknikë
14. E1-III-21-Instalime elektrike civile dhe industriale
15. V2-III-21-Instalime të sisteme të ftohje –ngrohje
16. N-IV-21-Veterinari
17. J1-III-21-Peshkim
18. E2-III-21-Instalime dhe mirëmbajtje të linjave të TU dhe TL
19. O-IV-16-Shërbime Social Shëndetësore
20. B1-III-17-Muratim-suvatim
21. M-II-21-Shërbime mjete transporti

Përgatiti: Diana Xhelili

12 janar 2022

ANEKS II VEPRIMTARIA E DREJTORISË SË ZHVILLIMIT TË PROGRAMEVE DHE OFRUESVE TË AFP-SË

Gjatë vitit 2021, Sektori i Skeletkurrikulave dhe Standardeve të Trajnimit të Mësuesve të AFP (SSTM) me specialiste A.Buci, E.Popa, E.Gega dhe T.Koçi, funksionoi si i tillë deri në 05.05.2021. Në vijim, krijohet Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Ofruesve të AFP (ZHPO) në përbërje të së cilës janë dy sektorë:

- a) Sektori i Hartimit të Kurrikulave dhe Materialeve Mbështetëse (HKMM) me specialiste: E.Popa, E.Gega dhe T.Koçi
- b) Sektori Zhvillimit të Vazhduar Profesional të Mësuesve të AFP (ZHVP) me specialiste: A.Buci

Ky raport paraqet të integruar, veprimtarinë dhe rezultatet e Sektorit të SSTM në periudhën 01.01.2021 – 04.05.2021 dhe veprimtarinë e rezultatet e Sektorëve të HKMM dhe të ZHVP (si pjesë e Drejtorisë së ZHPO), në periudhën 05.05.2021 – 31.12.2021. Këto veprimtari janë mbështetur në Planin e punës së AKAFPK për vitin 2021. Ndryshimi i strukturës imponoi modifikime dhe zgjerim të veprimtarive të planifikuara, tashmë të orientuara jo vetëm te aspektet kurrikulare, por edhe te mbështetja e drejtpërdrejtë e mësimdhënësve dhe ofruesve të AFP. Fokusi ka qënë jo vetëm përmbushja e objektivave për aspektet sasore të produkteve të planifikuara, por edhe garantimi i cilësisë së proceseve dhe produkteve përkatëse.

Veprimtaria e Sektorit të SSTM dhe e Drejtorisë së ZHPO gjatë vitit 2021 është kushtëzuar edhe nga vështirësitë dhe kufizimet e krijuara për shkak të ndikimit të pandemisë COVID 19. Fuqizimi i komunikimit dhe i mbështetjes së shkollave profesionale për mësimin online, puna me grupet e bashkpunëtorëve shumë herë në kushtet e distancimit social, komunikimet, takimet dhe trajnimet online, oraret e reduktuara të punës së përbashkët, këto janë disa tipare të kësaj veprimtarie edhe gjatë këtij viti të pandemisë.

Përgjithësisht, Sektori i SSTM dhe Drejtoria e ZHPO i ka përmbushur me sukses objektivat e planifikuara ose të rishikuara sipas situatave dhe mundësive konkrete. Përmbushja e objektivave erdhi edhe si rezultat i të qenit aktiv nga secili antar i sektorit, i punës në grup, i bashkëpunimit me sektorët e tjerë të Agjencisë, me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Me Agjencinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, me institucione të tjera, me Shkollat Profesionale dhe Drejtoritë Rajonale Ofruese të FP Publik (DR)FPP), me partnerët socialë dhe me projektet zhvillimore të donatorëve. Shkëmbimi i përvojave dhe vullneti për të ngritur në mënyrë të vazhdueshme nivelin profesional të specialistëve ka ndikuar gjithashtu pozitivisht në përmbushjen e detyrave.

Kontributet e Sektorit të SSTM dhe Drejtorisë së ZHPO.

Në zbatim të funksioneve dhe në plotësim të detyrave, Sektori i SSTM dhe Drejtoria e ZHPO, gjatë vitit 2021, ka kontribuar nëpërmjet kryerjes së një tërësie procesesh dhe realizimit të disa produkteve kryesore që kanë mbështetur zhvillimin e AFP si në nivel qendror, ashtu edhe në nivelin e ofruesve publikë të AFP.

Më poshtë renditen kontributet kryesore të ndara sipas fushave të veprimtarisë.

I. Hartimi dhe rishikimi i dokumentacionit kurrikular për AFP dhe mbështetja e zbatimit të tij.

Përgatitja e dokumentacionit kurrikular (skeletkurrikula, programe kursesh të unifikuara, materiale mësimore mbështetëse, programe lëndore, module profesionale, programe shkollore të periudhës para vitit 2008) përbën vëllimin më të madh të punës së sektorit të SSTM dhe Drejtorisë së ZHPO edhe gjatë vitit 2021. Moderimi i hartimit të dokumentacionit të ri kurrikular është bërë në përputhje me metodologjinë dhe formatet e miratuara dhe në zbatim të Udhëzimit të MFE, Nr. 27, dt. 30.07.2018, “Për formatet dhe procedurat kurrikulare të AFP”. Hartimi i dokumentacionit kurrikular është mbështetur edhe në dokumentet përkatëse të përgatitura nga Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale (përshkrime të profesioneve, standarde të profesioneve dhe përshkrime të kualifikimeve). Garanci për cilësinë e tyre ka qenë edhe përvoja e dhjetëra bashkëpunëtorëve dhe grupeve të punës me specialistë të AFP, si dhe të biznesit, të përzgjedhur me kujdes nëpërmjet procedurave zyrtare të AKAFPK.

Specialistët e Sektorit të SSTM dhe Drejtorisë së ZHPO kanë mbikëqyrur dhe kanë marrë informacione për ecurinë e zbatimit të skeletkurrikulave dhe programeve të kurseve të unifikuara, si dhe nevojave për materiale mësimore, nëpërmjet vizitave, takimeve të drejtpërdrejta dhe takimeve online me drejtues, mësues dhe instruktorë për shumicën e shkollave profesionale dhe DROFPP-ve të vendit. Bazuar në të dhënat e mbledhura, si dhe në ndryshimet në përshkruesit e kualifikimeve përkatëse, Sektori i SSTM dhe Drejtoria e ZHPO ka moderuar procesin e *hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të 21 skeletkurrikulave* për vitet shkollore 2021-22 dhe 2022-23, si dhe janë rishikuar *2 programe të lëndëve profesionale*.

Përsa i përket programeve të kurseve të unifikuara të formimit profesional, u moderua *hartimi i 10 programeve për Kurset e Unifikuara të FP*, bazuar edhe në përshkrimet/standardet e profesioneve përkatëse.

Për të mbështetur mësuesit e lëndëve profesionale dhe nxënësit në AP, duke konsideruar që në AP ka mungesa të theksuara të teksteve mësimore, si dhe në kushte e pandemisë ku mësimi online ka patur prioritet, Sektori i SSTM dhe Drejtoria e ZHPO ka analizuar gjendjen, ka përcaktuar nevojat më emergjente dhe ka moderuar procesin e hartimit të *25 materialeve mësimore mbështetëse* të lëndëve profesionale të AP. Me mbështetjen e Save the Children, është rishikuar edhe materiali mësimor mbështetës për lëndën “*Bazat e sipërmarrjes*”, kl.13.

Në zbatim të Urdhërit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me Nr. 115, dt. 18.05.2020, “Për trajtimin e kërkesave të personave për pajisje me programet mësimore lëndore të zbatuara në institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë në Republikën e Shqipërisë para vitit shkollor 2008-2009”, Sektori i SSTM dhe Drejtoria e ZHPO ka përgatitur *programet sintetike* të zbatuara në shkollat profesionale para vitit 2008 dhe ka plotësuar kërkesat për *90 aplikues*, për të tilla programe.

Gjatë vitit 2021, janë kryer edhe produrat e duhura dhe është mundësuar *transferimi i 5 nxënësve*, nga shkollat profesionale jashtë vendit, në shkollat profesionale të vendit tonë.

II. Trajnimi dhe udhëzimi i mësimeve në AFP.

Gjatë vitit 2021, Sektori i SSTM dhe Drejtoria e ZHPO kanë mbikëqyrur zbatimin e produkteve kurrikulare në SHP-të dhe DROFPP-të, si dhe kanë udhëzuar e këshilluar dhe

mësuesit/instruktorët, koordinatorët e NJZH dhe drejtuesit e foruesve të AFP, në lidhje me to. Kjo mbështetje është kryer si nëpërmjet kontakteve dhe takimeve të drejtpërdrejta (gjatë takimeve në AKAFPK dhe vizitave në ofruesit e AFP) ashtu edhe nëpërmjet komunikimeve në distancë dhe online (e-mail, biseda telefonike, ëbinare). Informacione me vlerë janë marrë edhe gjatë trajnimeve për “Bazat e Didaktikës në AFP”, për funksionet e Njësive të Zhvillimit (NJZH) dhe për aspekte të tjera, të dhjetra mësuesve, koordinatorëve dhe drejtuesve të shkollave profesionale dhe DROFPP-ve, në të cilat tre specialistë kanë qenë edhe trajnerë.

Në kuadër të fillimit të vitit shkollor 2021-22, Sektori i SSTM dhe Drejtorja e ZHPO kontribuoi në përgatitjen dhe publikimin e një “Udhëzuesi për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale” me informacione mjaft të dobishme për aspektet kurrikulare, të mësimdhënies, të vlerësimit të nxënësve, të organizimit orarit të shkollave, të orientimit të tyre nga kërkesat e tregut rajonal të punës etj. Përsa i përket mbështetjes së mësimdhënësve të AFP për aspektet didaktike, specialistët e Sektori të SSTM dhe Drejtorisë së ZHPO, në takimet, bashkëbisedimet dhe vëzhgimet e kryera në shkollat profesionale dhe DROFPP-të, kanë marrë të dhëna për gjendjen e mësimdhënësve dhe kanë ofruar mbështetjen e tyre për aspekte të ndryshme didaktike. Gjithashtu, janë bërë propozime konkrete për ndryshimet e nevojshme në sistemin e zhvillimit të vazhduar profesional të mësimdhënësve në AFP, duke qenë pjesë aktive e ndryshimeve ligjore për institucionalizimin dhe mbështetjen e “Njësive të Zhvillimit” në ofruesit e AFP.

Edhe gjatë vitit 2021, Sektori i SSTM dhe Drejtorja e ZHPO janë angazhuar në zbatimin e Programit të Trajnimit 24 ditor për “Bazat e didaktikës në AFP” për 5 grupe (rreth 100 mësimdhënës), të rajoneve të Tiranës, Elbasanit dhe Durrësit, të mbështetur nga GIZ dhe Save the Children. Tre pjestarë të Sektorit kanë kontribuar drejtpërdrejt jo vetëm në koordinimin dhe harmonizimin e zbatimit të këtij programi, por edhe në trajnimin e drejtpërdrejtë të këtyre 5 grupeve të mësimdhënësve.

Anëtarët e Sektorit të SSTM dhe Drejtorisë së ZHPO janë angazhuar edhe si trajnerë në hartimin e programeve të trajnimit dhe në moderimin e seancave të trajnimeve (me prezencë fizike dhe online), si më poshtë:

- Për rreth 50 mësues të lëndës “Bazat e sipërmarrjes” (mbështetur nga Save the Children).
- Për rreth 25 Koordinatorë të Marrëdhënieve me Biznesin (mbështetur nga OeAD).
- Për rreth 40 Koordinatorë të Zhvillimit të Vazhduar Profesional (mbështetur nga S4J).
- Për rreth 40 Koordinatorë të Kurrikulave (mbështetur nga S4J).

Një kontribut i drejtpërdrejtë është dhënë në përbërje të grupeve të punës edhe në përgatitjen e Udhëzuesit për Koordinatorë të Zhvillimit të Vazhduar Profesional dhe Udhëzuesit për Koordinatorë të Kurrikulave , të mbështetura nga S4J.

III. Monitorime për zbatimin e kurrikulave qendrore dhe për ecurinë e funksionimit të Njësive të Zhvillimit në ofruesit e AFP:

- Janë kryer vizita monitoruese dhe mbledhje informacioni mbi ecurinë e zbatimit të Skeletkurrikulave të AP në 24 shkolla profesionale të Tiranës, Rubikut, Peshkopisë, Kukësit, Durrësit, Golemit, Kavajës, Elbasanit, Cërrikut, Pogradecit, Korçës, Lushnjës, Beratit, Fierit dhe Vlorës.

- Janë kryer vizita monitoruese dhe mbledhje informacioni mbi ecurinë e zbatimit të Programeve të Kurseve të Unifikuara të FP në 5 DRFPP të Durrësit, Elbasanit, Korçës, Fierit, Vlorës.
- Janë kryer vizita monitoruese dhe mbledhje informacioni mbi ecurinë e funksionimit të Njësive të Zhvillimit në 24 shkolla profesionale dhe 5 DRFPP të Tiranës, Rubikut, Peshkopisë, Kukësit, Durrësit, Golemit, Kavajës, Elbasanit, Cërrikut, Pogradecit, Korçës, Lushnjës, Beratit, Fierit dhe Vlorës.
- Është përgatitur Raporti i monitorimit të zbatimit të skeletkurrikulave, të programeve të kurseve të unifikuara dhe të ecurisë në Njësitë e Zhvillimit, bazuar në vizitat e kryera.

IV. Veprimtari në kuadrin e bashkëpunimeve.

Një pjesë e ndjeshme e kohës së punës së Sektorit të SSTM i është kushtuar veprimtarive të ndryshme në kuadrin e porosive të Ministrisë përgjegjëse për AFP (MFE) dhe të bashkëpunimeve të kryera me institucione kombëtare dhe aktorë të tjerë, me projektet e donatorëve dhe institucionet e ndryshme ndërkombëtare që janë partnerë të rëndësishëm në zhvillimin e AFP në Shqipëri. Të tilla veprimtari janë:

- Pjesëmarrje në procesin e rishikimit të kuadrit ligjor të AFP, hartimit të drafteve të akteve nënligjore të AFP (kryesisht për Udhëzimin e MFE, Nr. 14, dt. 25.05.2021, draftin e Udhëzimit për Kualifikimin e mësimeve të specialistëve në AFP, Udhëzimit për Akreditimin e ofruesve të AFP, si dhe akte të tjera). Këto kontribute janë dhënë nëpërmjet pjesëmarrjes në grupet e punës përkatëse, në përgatitjen e drafteve të para ose në formën e komenteve me shkrim për draftet e paraqitura.
- Pjesëmarrje në Komitetin e Maturës Shtetërore, komente për aktet nënligjore të lidhura me Maturën Shtetërore Profesionale (udhëzimet dhe rregulloret).
- Pjesëmarrje në takime për diskutimin, si dhe komentimi i dokumenteve të ndryshme të Drejtorisë apo të njësive të tjera të AKAFPK, në kuadrin e bashkëpunimit të brendshëm të AKAFPK.
- Pjesëmarrje në Komisionin e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve, anëtarë të grupeve të punës, për produktet e AKAFPK
- Pjesëmarrje në Komisionin e transferimit të nxënësve në AP.
- Pjesëmarrje në komisionin e inventarizimit në AKAFPK.
- Pjesëmarrje në komisionin për prokurimet publike të AKAFPK
- Përgatitja e planit të buxhetit të Sektorit të SSTM dhe Drejtorisë së ZHPO, si dhe ndryshimet eventuale gjatë vitit.
- Komente dhe plotësime në Rregulloren dhe Udhëzimin për Maturën Shtetërore Profesionale, 2021-22.
- Komente për Urdhërin për fillimin e vitit shkollor 2021-22 (kërkesë nga MAS)
- Takime në MFE për aspekte të ndryshme të AFP.
- Takime, diskutime konsultive të vazhdueshme dhe pjesëmarrje aktive në veprimtari të EPALE
- Pjesëmarrje aktive në Ëëbinar-et e EPALE
- Komente për draftin e Pyetësorit për Vlerësimin e Procesit mësimor 2020-21, si dhe për Raportin e studimit përkatës, përgatitur nga S4J.

- Komente për draftin e Programit të Trajnimit për Dixhitalizimin në AFP, përgatitur nga S4J.
- Pjesmarrje në Programin Rajonal (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut) “Shkolla takon Biznesin”, mbështetur nga OeAD.
- Pjesmarrje dhe prezantime në Takimet dhe Trajnimet për “Shkolla takon Biznesin”, organizuar në Tiranë ose online (OeAD).
- Pjesmarrje dhe kontribute në takimet online dhe veprimtaritë e organizuara nga ETF për programin e trajnimit të Koordinatorëve të ZHVP dhe aspekte të tjera të AFP.
- Takime dhe kontribute në kuadrin e veprimtarive online të projektit S4J.
- Takime dhe shkëmbime informacioni me konsulentët e Programit për mbështetjen e zbatimit të kualifikimit “Shërbime mekatronike në automjete” (GIZ)
- Pjesmarrje në takimet dhe ëbinaret online për aspekte të ndryshme të AFP, organizuar nga S4J, GIZ, EPALE, ETF, UNDP etj.

V. Veprimtari të tjera.

Sektori i SSTM dhe Drejtoria e ZHPO, gjatë vitit 2021 kanë kryer edhe veprimtari të tjera që lidhen me:

- Përgatitjen e dokumentacionit zyrtar që ka të bëjë me veprimtarinë dhe produktet e (raporte mujore dhe vjetore, plane mujore dhe vjetore, listë-prezenca të stafit, shkresa të ndryshme, njoftime për bashkëpunëtorët, përzgjedhja e bashkëpunëtorëve, kontratat për bashkëpunëtorët, dokumentacioni për pagesat e bashkëpunëtorëve, planifikimi i buxhetit të sektorit, dokumentacioni financiar, vlerësimi i stafit, materialet për publikime në faqe interneti etj.).
- Kontribute në rifreskimin me informacione të faqes së internetit të AKAFPK.
- Pjesmarrje në komisione dhe komitete të ndryshme (Komisionin e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve të AKAFPK, Komisionin e prokurimeve publike në AKAFPK, Komisionin e inventarizimit, Komisionin e Transferimit të nxënësve, Komitetin e Maturës Shtetërore)
- Trajnimin dhe vet-trajnimin e vazhdueshëm të stafit. Kjo është kryer nëpërmjet studimit individual, shkëmbimit të përvojës, pjesëmarrjes në veprimtari trajnimi të drejtpërdrejta ose online, kryesisht të ofruara nga ASPA dhe donatorët, ndjekjes së kualifikimeve formale etj.

Një përmbledhje e produkteve kryesore të Sektorit të SSTM dhe Drejtorisë së ZHPO, të realizuara gjatë vitit 2021, tregohet në Aneksin e mëposhtëm.

ANEKS 1 - Lista e produkteve për vitin 2021

I. Skeletkurrikula të reja të Arsimit Profesional (6 skeletkurrikula):

1. Skeletkurrikuli i ri i profilit mësimor “Programim”, Niv. IV i KSHK (në drejtimin “TIK”)
2. Skeletkurrikuli i ri i profilit mësimor “Instalime hidraulike”, Niv. III i KSHK, të drejtimit mësimor “Termohidraulikë”.
3. Skeletkurrikuli i ri i profilit mësimor “Instalime të sistemeve ftohje-ngrohje”, Niv. III i KSHK, të drejtimit mësimor “Termohidraulikë”.
4. Skeletkurrikuli i ri i profilit mësimor “Multimedia”, Niv. IV i KSHK (në drejtimin “Teknologji informacioni dhe komunikimi”).
5. Skeletkurrikuli i ri i profilit mësimor “Administrim zyre”, Niv. IV i KSHK (në drejtimin “Ekonomi biznes”).
6. Skeletkurrikuli i ri i profilit mësimor “Mekatronikë automjetesh”, Niv. V i KSHK, pas të mesmes (në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”).

II. Skeletkurrikula të rishikuara të Arsimit Profesional (15 skeletkurrikula):

1. Skeletkurrikuli i drejtimit mësimor “Ndërtim”, Niv. II i KSHK.
2. Skeletkurrikuli i drejtimit mësimor “Përpunim druri”, Niv. II i KSHK.
3. Skeletkurrikuli i drejtimit mësimor “Detari”, Niv. II i KSHK.
4. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Shërbime kujdesi për të moshuar”, Niv. III i KSHK.
5. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Rrjete të dhënash”, Niv. IV i KSHK (në drejtimin “TIK”).
6. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Mbështetje e përdoruesve të TIK”, Niv. IV i KSHK (në drejtimin “TIK”).
7. Bashkëpunëtorë për rishikimin e skeletkurrikulit të profilit mësimor “Elektroteknikë”, Niv. IV i KSHK.
8. Bashkëpunëtorë për rishikimin e skeletkurrikulit të profilit mësimor “Teknologji ushqimore”, Niv. II i KSHK.
9. Bashkëpunëtorë për rishikimin e skeletkurrikulit të profilit mësimor “Ekonomi biznes”, Niv. II i KSHK.
10. Bashkëpunëtorë për rishikimin e skeletkurrikulit të profilit mësimor “Zhvillim ëbsite”, Niv. IV i KSHK (në drejtimin “Teknologji informacioni dhe komunikimi”).
11. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Shttrim dhe veshje me pllaka”, Niv. III i KSHK, të drejtimit mësimor “Ndërtim”.
12. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Punime dekorative dhe bojatisje”, Niv. III i KSHK, të drejtimit mësimor “Ndërtim”.
13. Skeletkurrikuli i profilit mësimor “Miniera”, Niv. III i KSHK, të drejtimit mësimor “Gjeologji miniera”.
14. Skeletkurrikuli i drejtimit mësimor “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”, Niv. II i KSHK.
15. Skeletkurrikuli i drejtimit mësimor “Veterinari”, Niv. IV i KSHK.

III. Programe lëndore:

1. Rishikimi i programit të përgjithshëm dhe programit analitik të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13 (64 orë), për të gjitha drejtimet/profilet mësimore.
2. Rishikimi i programit të përgjithshëm të lëndës “Drejtimi, ligjshmëria dhe ekonomia në bujqësi”, kl.13 (96 orë) për drejtimin “Bujqësi”.

IV. Programe të Kurseve të Unifikuara të Formimit Profesional (10 programe):

1. Kursi i unifikuar i formimit profesional për “Punime ndërtimi”.
2. Kursi i unifikuar i formimit profesional për “Automekanik”.
3. Kursi i unifikuar i formimit profesional për “Punime druri”.
4. Kursi i unifikuar i formimit profesional për “Përpunim mishi”.
5. Kursi i unifikuar i formimit profesional për “Termohidraulikë”.
6. Kursi i unifikuar i formimit profesional për “Prodhime brumi”.
7. Kursi i unifikuar i formimit profesional për “Shërbime udhëtimi”.
8. Kursi i unifikuar i formimit profesional për “Përpunim qumështi”.
9. Kursi i unifikuar i formimit profesional për “Përpunim fruta perime”.
10. Kursi i unifikuar i formimit profesional për “Mekanikë bujqësore”.

V. Materiale mësimore për lëndët profesionale:

1. Për lëndën “Edukimi shëndetësor dhe higjiena”, 11, (68 orë), të drejtimit mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.
2. Për lëndën “Bazat e prerjes”, kl.10, (72 orë), të drejtimit mësimor “Tekstil konfeksione”.
3. Për lëndën “Njohuri bazë të kopshtarisë”, kl.12, (102 orë), të profilit mësimor “Kopshtari”.
4. Për lëndën “Bazat e bujqësisë”, kl.11 (34 orë), të drejtimit mësimor “Bujqësi”.
5. Për lëndën “Botanikë e fiziologji e bimëve”, kl 10 (72 orë), në drejtimin mësimor “Pyje”.
6. Për lëndën “Gjeografi turistike”, kl.13 (64 orë) në drejtimin mësimor “Hoteleri turizem”.
7. Për lëndën “Bazat e programimit”, kl.10 (72 orë) dhe kl.11 (34 orë), në drejtimin mësimor “Teknologji informacioni dhe komunikimi”.
8. Për lëndën “Mjetet motorike bujqësore”, kl.12 (72 orë) të profilit mësimor “Teknologji bujqësore”.
9. Për lëndën “Gjeografia dhe turizmi”, 13, (64 orë), të profilit mësimor “Sipërmarrje e agjencisë turistike”.
10. Për lëndën “Trashëgimi kulturore dhe historike”, kl.13, (64 orë), të profilit mësimor “Sipërmarrje e agjencisë turistike”.
11. Për lëndën “Mbarështrim pyjesh dhe kullotash”, kl.12, (72 orë), të profilit mësimor “Silvikulturë”.
12. Për lëndën “Mbarështrim pyjesh dhe kullotash”, kl.13, (64 orë), të profilit mësimor “Silvikulturë”.
13. Për lëndën “Bazat e shtetit dhe të së drejtës”, kl.12, (108 orë), të profilit mësimor “Administrim zyre”.
14. Për lëndën “Bazat e menaxhimit”, kl.12 (72 orë), të profilit mësimor “Administrim zyre”.
15. Për lëndën “Sjellje konsumatore”, kl.13 (64 orë), të profilit mësimor “Tregti”.
16. Për lëndën “Kirurgji veterinare”, kl.11 (72 orë), të drejtimit mësimor “Veterinari”.
17. Për lëndën “Mikrobiologji veterinare”, kl.11 (36 orë), të drejtimit mësimor “Veterinari”.
18. Për lëndën “Farmakologji”, kl.12 (36 orë), të drejtimit mësimor “Veterinari”.
19. Për lëndën “Kontroll blegtoral”, kl.13 (32 orë), të drejtimit mësimor “Veterinari”.
20. Për lëndën “Dizenjim aplikacionesh”, kl.12 (72 orë), të profilit mësimor “Programim”.
21. Për lëndën “Programimi në rrjete”, kl.12 (72 orë), të profilit mësimor “Rrjete të dhënash”.
22. Për lëndën “Marketing”, 12, (72 orë), të profilit mësimor “Tregti”.
23. Për lëndën “Prodhim bimor”, kl.12, (136 orë), të profilit mësimor “Prodhim bimor”.

24. Për lëndën “Teknikat e konstruksioneve për punimet e muraturës, betoneve dhe betonarmesë”, kl.12, (68 orë), të profilit mësimor “Mirëmbajtje ndërtesash”.
25. Për lëndën “Etika profesionale dhe legjislacioni”, kl.10 (108 orë), të drejtimit mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.
26. Për lëndën “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13 (64 orë), për të gjitha drejtimet/profilet mësimore

VI. Udhëzuesat:

1. Udhëzues për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale, në kuadrin e fillimit të vitit shkollor 2021-2022 (në bashkëpunim)
2. Udhëzues për Ndryshimet në skeletkurrikulat e kualifikimeve profesionale në vitin shkollor 2021-22.
3. Udhëzues për Koordinatorë të Zhvillimit të Vazhduar Profesional, në proces (në bashkëpunim me S4J).
4. Udhëzues për Koordinatorë të Kurrikulave, në proces (në bashkëpunim me S4J).

Përgatiti: Alqi Mustafai

12 janar 2022

ANEKS III SEKTORI I VLERËSIM-CERTIFIKIMIT TË NXËNËSVE & AKREDITIMIT TË OFRUESVE TË AFP-SË (1 JANAR - 4 MAJ 2021) SEKTORI I AKREDITIMIT TË OFRUESVE TË AFP-SË (5 MAJ – 31 DHJETOR 2021)

Përgjatë vitit 2021, Sektori i Vlerësim-certifikimit të nxënësve dhe Akreditimit të ofruesve të AFP-së (SVCA), për realizimin e veprimtarive të planifikuara, është mbështetur në objektivat vjetore të kësaj njësie organizative, si dhe në objektivat specifike për çdo punonjës të tij. Sektori është fokusuar në dy drejtime kryesore:

- I. Zhvillimi i kriterëve dhe standardeve të vlerësimit të nxënësve/kursantëve
- II. Sigurimi i Cilësisë

Realizimi i të gjitha objektivave të Sektorit në kohë dhe me cilësi, ka ardhur si rezultat edhe i rritjes së shkallës së dedikimit, angazhimit dhe punës në ekip të stafit, bashkëpunimit me sektorët e tjerë të Agjencisë, bashkëpunimit ndërinstytucional dhe me shkollat e qendrat e formimit profesional, si dhe me projektet e ndryshme. Si çdo vit, gjatë punës së tij, sektori konsultohet në vijimësi me dokumente të fushës së AFP-së si manuale, udhëzuesa dhe dokumente strategjike të ndryshëm.

Veprimtari për zhvillimin e kriterëve dhe standardeve të vlerësimit dhe certifikimit të nxënësve

Hartimi dhe rishikimi i programeve orientuese të niveleve

Në kuadër të planit vjetor të punës, gjatë vitit 2021, Sektori ndërmori dhe monitoroi procesin e hartimit të 5 programeve orientuese për provimet përfundimtare të niveleve.

Për hartimin e programeve të reja sektori mblodhi informacion nga shkollat profesionale, për kualifikimet e reja që ofrohen nga ato, për identifikimin e nevojave përkatëse. Informacion i mbledhur gjatë periudhës Tetor-Nëntor 2020. Po ky informacion është grumbulluar edhe në periudhën Tetor-Nëntor 2021, i cili do të nevojitet për planifikimin e detyrave për vitin 2022. Kështu, nga verifikimi i ofertës për vitin shkollor 2020-2021 rezultoi nevoja e hartimit të 5 programeve orientuese për provimet përfundimtare të niveleve **(Shih aneksin 1)**.

Për rishikimin e programeve orientuese sektori mori informacionin e nevojshëm nga ndryshimet e bëra në skeletkurrikulat përkatëse. Nga verifikimi rezultoi nevoja e rishikimit të 26 programeve orientuese. **(Shih aneksin 1)**

Gjithashtu, është pasuruar dhe regjistri për të gjithë ofruesit, me të dhëna si numri i nxënësve që ofrohen në kualifikimet profesionale përkatëse në të gjithë sistemin tonë të Arsimit Profesional. Kontribut në rubrikat përkatëse që lidhen me vlerësimin dhe certifikimin e nxënësve në udhëzuesin e fillimit të vitit shkollor, për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale.

Hartimi dhe rishikimi i programeve orientuese të Maturës Shtetërore Profesionale

Për hartimin dhe rishikimin e programeve të reja orientuese të Maturës Shtetërore Profesionale, sektori mblodhi informacion nga shkollat profesionale, për kualifikimet e reja që ofrohen.

Në këtë kuadër, u hartuan 4 programe të reja orientuese të Maturës Shtetërore Profesionale dhe u rishikuan 10 programe orientuese të Maturës Shtetërore Profesionale. (**Shih Aneksin 2**)

U plotësuan 38 programe orientuese të Maturës Shtetërore Profesionale me referencat e bazës ligjore (Udhëzuesi i përbashkët MAS-MFE dhe Rregullorja e Maturës Shtetërore 2021). (**Shih Aneksin 3**).

Banka testesh

Një nga veprimtaritë e sektorit, në mbështetje të shkollave profesionale për ofrimin e kualifikimeve profesionale cilësore, është përgatitja e bankave me njësi testi (instrumente vlerësimi) për provimet përfundimtare, por edhe për vlerësimin e vazhduar të nxënësve. Për vitin 2021 ishte planifikuar hartimi i 1100 njësive të testit (për 8 kualifikime profesionale) (**Shih Aneksin 4**). Sipas këtij planifikimi të gjitha njësitë janë realizuar. Pas përfundimit të tyre janë plotësuar kështu pothuaj të gjitha kualifikimet profesionale. Shkollat janë orientuar t'i përdorin këto instrumente si gjatë vitit shkollor, ashtu edhe për hartimin e testeve të provimeve përfundimtare. Nga vizitat e kryera nëpër të gjithë ofruesit e AP-së për monitorimin e përdorimit të këtyre bankave rezultoi, se të gjitha shkollat i gjejnë një ndihmesë mjaft të vlefshme dhe i përdorin ato në vazhdimësi.

Certifikimi

Hartimi dhe rishikimi i listës së kompetencave profesionale (që pasqyrohen në certifikatat e niveleve), për 20 kualifikimet profesionale të tri strukturave të ofruara, në nivelet përkatëse të tyre.

Sigurimi i Cilësisë

Në kuadër të bashkëpunimit me UNDP-në, Programi “Zhvillimi i Aftësive për Punësim” dhe me mbështetjen e MFE janë realizuar këto veprimtari:

Procesi i Vetëvlerësimit të IoAFP-ve

Gjatë këtij viti i gjithë procesi i vetëvlerësimit të ofruesve të AFP-së, u zhvillua sipas një kalendari të miratuar nga AKAFPJ-ja, për të gjitha hapat e procesit dhe u arritën këto objektiva dhe veprimtari si më poshtë:

- Mbështetja e ofruesve në trajnimin e përdorimit të platformës elektronike të vetëvlerësimit, si dhe finalizimi i procesit të vetëvlerësimit për 44 institucione publike dhe 2 institucione private.
- Dorëzimi i raporteve finale të vetëvlerësimit nga të gjithë ofruesit e AFP-së, 44 institucione publike dhe 2 privatë (qendër+shkollë), përfshirë kontrollin e "gatishmërisë" për akreditim"
- Organizimi i pesë takimeve rajonale (Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Korçë) me qëllim diskutimin mbi rezultatet e procesit të vetëvlerësimit të IoAFP-ve dhe zbatimi i tij nëpërmjet platformës digjitale, lehtësitë dhe problemet gjatë hedhjes së të dhënave.

Për periudhën në të cilën u zhvillua procesi i vetëvlerësimit, për vitin shkollor 2019-2020, në nivel kombëtar pati vlerën 1.8

Në vijim, për vitin shkollor 2021-2022 procesi i vetëvlerësimit do të kryhet mbështetur në udhëzimin nr. 18, datë 6.7.2021 për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 16, datë 8.5.2018, “për zhvillimin e vetëvlerësimit në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional”, ku të gjithë IoAFP-të do të vlerësojnë të pesë fushat e cilësisë. Për këtë, është hartuar dhe shpërndarë Kalendar i zbatimit të procesit të vetëvlerësimit në institucionet ofruese të AFP-së.

Procesi i Akreditimit të IoAFP-ve

AKAFPK-ja, në bashkëpunim me UNDP-në, Programi “Zhvillimi i Aftësive për Punësim” ka zhvilluar për herë të parë tashmë, me një ekspertizë ndërkombëtare, një model të plotë të procesit të Akreditimit, për Institucionet ofruese të AFP-së.

Në mbështetje të këtij procesi janë zhvilluar veprimtari dhe dokumente si më poshtë:

- Konsolidimi i bazës ligjore, urdhri nr. 128, datë 6. 7. 2021 për miratimin e rregullores “për standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional”
- Hartimi i procedurave, dokumenteve dhe formularëve të standardizuar të akreditimit.
- Udhërrëfytyesi për procesin e akreditimit. Në këtë kuadër u zhvillua modeli i parë i sistemit të akreditimit, me standardet, procedurat, instrumentet dhe udhëzimet e zbatimit të procesit.
- Rekrutimi, përzgjedhja dhe trajnimi i vlerësuesve të jashtëm dhe trajnimi i ekspertëve të brendshëm të AKAFPK-së. Ky program trajnimi u zhvillua në dy grupe, në total 40 kandidatë vlerësues të jashtëm dhe 4 specialistë të AKAFPK-së. U pajisën me certifikatë 17 vlerësues nga grupi i parë i vlerësuesve të jashtëm për akreditimin e ofruesve të arsimit dhe formimit profesional i cili u zhvillua gjatë periudhës qershor-dhjetor 2021, në total 10 ditë/60 orë trajnimi (36 orë teori dhe 24 orë praktikë). Po vijon procesi i vlerësimit të grupit të dytë të kandidatëve për vlerësues të jashtëm të IoAFP-ve.
- Realizimi i pilotimit/simulimit të procesit të akreditimit, bazuar në gatishmërinë e ofruesit për akreditim. Në këtë proces u përfshinë 5 institucione ofruese të arsimit profesional, ku u përzgjodhën 6 kualifikime profesionale nga oferta e tyre arsimore.

Veprimtari në kuadër të bashkëpunimeve

Në kuadër të bashkëpunimit me MFE, janë kryer këto veprimtari:

- Në bashkëpunim me Drejtorinë e AFP-së, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë u përgatit drafti i Udhëzimit për “Organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2022 dhe për Rregulloren e Maturës Shtetërore 2022.
- Pjesëmarrje në grupin e inspektimit për licencimin e ofruesve privat të AFP-së.

Në kuadër të bashkëpunimit me MAS, janë kryer këto veprimtari:

- Dhënia e kontributeve për hartimin e draftit të Rregullores së Maturës Shtetërore 2021-2022.
- Përgatitja e informacionit të kërkuar nga QSHA për të gjitha planet mësimore të kualifikimeve profesionale të Arsimit Profesional, për Maturën Shtetërore Profesionale 2021, të ofruara nga shkollat profesionale, informacion ky që shërben për platformën “Maturanti.”
- Mbështetja e QSHA-së në koordinimin e grupeve të punës për hartimin e testeve të teorisë profesionale të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, për kualifikimet e reja.
- Në bashkëpunim me QSHA-në, ndjekja e problematikës me nxënësit maturantë të shkollave profesionale, plotësimin e rubrikave të Certifikatës së Maturës Shtetërore Profesionale tek platforma “Maturanti.”
- Mbështetja dhe konsultimi i vazhdueshëm për problematikën e provimeve të Maturës Shtetërore 2021 dhe të dhënave të portalit “Maturanti”.
- Komente dhe sugjerime mbi draftin e strukturës të vitit të ri shkollor 2021-2022.
- Pjesëmarrje në takim në kuadër të implementimit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Para-universitar (SMIP).
-

Në kuadër të projektit EPALE, janë kryer këto veprimtari:

- Pjesëmarrje në mbështetje të aktiviteteve për të Nxënit e të Rriturve.

Veprimtari në kuadër të projektit të Kultur-Kontakt:

- Pjesëmarrje dhe moderim në takime me fokus “GENDER IN SELF-EVALUATION”.
- Kontribut në zhvillimin e instrumentit për “Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë si dhe përdorimi i rezultateve nga identifikimi i problemeve”.
- Kontribut në lidhje me integrimin e aspekteve gjinore në sigurimin e cilësisë, mbi arritjen e qëllimeve të përbashkëta përmes aktiviteteve dhe projekteve shkollore.

Përgatitja e termave të referencës për bashkëpunëtorët e jashtëm

Pjesë e punës së sektorit është edhe përgatitja e termave të referencës për bashkëpunëtorët e jashtëm:

- Ndjekja e procedurave për njoftimet për bashkëpunëtorë, për hartimin apo rishikimin e programeve orientuese, si dhe hartimin e bankave të testeve për provimet përfundimtare.
- Përgatitja e kontratave të shërbimit, për bashkëpunëtorët e SVCA-së që shpallen fitues.
- Përgatitja e urdhër-pagesave dhe ndjekja e procedurave për pagesën e bashkëpunëtorëve.

Të tjera

Sektori është angazhuar edhe në disa veprimtari të tjera që lidhen ose jo drejtpërdrejt me përshkrimin e punës së tij:

- Përcaktimi i objektivave të vitit.
- Hartimi i planeve mujore të detajuara dhe raportimi i tyre.

- Hartimi i planit vjetor dhe raportimi i tij.
- Mirëmbajtja e rubrikës së Vlerësim Certifikimit në faqen e AKAFP-së.

SVCA – Lista e produkteve për vitin 2021

Programe orientuese të reja:

- 1) Shërbime të udhëtimit dhe turizmit Niveli IV në KSHK
- 2) Mirëmbajtje ndërtesash Niveli III në KSHK
- 3) Riparime të pajisjeve elektronike Niveli IV në KSHK
- 4) Telekomunikacion, Niveli IV në KSHK
- 5) Teknologji bujqësore, Niveli IV në KSHK

Programe orientuese të rishikuara:

- 1) Tekstil konfeksione Niveli IV në KSHK
- 2) Mekanikë Niveli IV në KSHK
- 3) Hoteleri turizëm Niveli IV në KSHK
- 4) Tekstil Niveli III në KSHK
- 5) Modelim Niveli III në KSHK
- 6) Instalim elektrik civil dhe industrial Niveli III në KSHK
- 7) Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL Niveli III në KSHK
- 8) Riparime të pajisjeve elektro-shtëpiake Niveli III në KSHK
- 9) Elektromekanikë Niveli III në KSHK
- 10) Makina metalpunuese Niveli III në KSHK
- 11) Frutikulturë Niveli III në KSHK
- 12) Ferma bujqësore e blegtorale Niveli III në KSHK
- 13) Kopshtari Niveli III në KSHK
- 14) Prodhim bimor Niveli III në KSHK
- 15) Shërbime kujdesi për fëmijë Niveli III në KSHK
- 16) Teknologji e përpunimit të naftës Niveli III në KSHK
- 17) Teknologji kimike Niveli II në KSHK
- 18) Teknologji informacioni dhe komunikimi Niveli II në KSHK
- 19) Elektroteknikë, IV në KSHK
- 20) Bujqësi, II në KSHK
- 21) Bujqësi, IV në KSHK
- 22) Sigurime IV në KSHK
- 23) Shërbime bankare, IV në KSHK
- 24) Llogari, IV në KSHK
- 25) Sipërmarrje e agjencisë turistike, IV në KSHK
- 26) Tregti, IV në KSHK

Programe orientuese të reja të Maturës Shtetërore Profesionale

- 1) Shërbime të udhëtimit dhe turizmit

- 2) Riparime të pajisjeve elektronike
- 3) Telekomunikacion
- 4) Teknologji bujqësore

Programe orientuese të rishikuara të Maturës Shtetërore Profesionale

- 1) Tekstil konfeksione
- 2) Mekanikë
- 3) Hoteleri turizëm
- 4) Elektroteknikë
- 5) Bujqësi
- 6) Sigurime
- 7) Shërbime bankare
- 8) Llogari
- 9) Sipërmarrje e agjencisë turistike
- 10) Tregti

Programe orientuese të Maturës Shtetërore Profesionale (Rishikimi i bazës ligjore)

- 1) Hoteleri-turizëm
- 2) Shërbime mjetesh transporti
- 3) Mekanikë
- 4) Elektroteknikë
- 5) Elektronikë
- 6) Përpunim druri
- 7) Ndërtim
- 8) Tekstil-konfeksione
- 9) Tekstil-konfeksione (NABER ADA)
- 10) Teknologji ushqimore
- 11) Bujqësi
- 12) Shërbime sociale dhe shëndetësore
- 13) Instalues i sistemeve termohidraulike
- 14) Teknologji kimike
- 15) Peshkim
- 16) Detari
- 17) Gjeologji-miniera
- 18) Llogari
- 19) Shërbime bankare
- 20) Sipërmarrje e agjencisë turistike
- 21) Sigurime
- 22) Tregti
- 23) Administrim biznesi
- 24) Rrjete të dhënash
- 25) Mbështetje e përdoruesve të TIK

- 26) Zhvillim ëbsite
- 27) Rrjete të dhënash (pilot-GIZ)
- 28) Inxhinieri informatike softëaresh (Hermann Gmeiner)
- 29) Silvikulturë
- 30) Agrobiznes
- 31) Veterinari
- 32) Gjeodezi
- 33) Biznes (Harry Fultz)
- 34) Elektronikë (Harry Fultz)
- 35) Automekanik (Harry Fultz)
- 36) Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji
- 37) Shërbime kujdesi për të moshuar (pilot GIZ)
- 38) Shërbime të udhëtimit dhe turizmit

Banka testesh (1100 njësi):

- 1) Shërbime të udhëtimit dhe turizmit” niveli IV në KSHK
- 2) Kërkim, shpim dhe frytëzim nafte gazi dhe uji” niveli IV në KSHK
- 3) Nxjerrja e naftës, gazit dhe ujit” niveli III në KSHK
- 4) Elektroteknikë, niveli II në KSHK
- 5) Mirëmbajtje ndërtesash niveli III në KSHK
- 6) Agroturizëm niveli III në KSHK
- 7) Elektromekanike niveli III në KSHK
- 8) Peshkim niveli III në KSHK

Suplementi i certifikatave profesionale për 20 kualifikime profesionale (2 kualifikime profesionale të reja dhe 18 kualifikime profesionale të rishikuara).

Përgatiti: Etleva Kaculi

12 janar 2022

ANEKS IV SEKTORI I ADMINISTRATËS, FINANCËS DHE TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT(1 JANAR - 4 MAJ 2021) SEKTORI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE PROJEKTEVE (5 MAJ – 31 DHJETOR 2021)

Reforma në administratën publike ka vazhduar të jetë në qendër të vëmendjes së qeverisë shqiptare. Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 155, datë 24.11.2020 “Për Miratimin e Strukturës së Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve” si dhe dokumentit zyrtar të Departamentit të Administratës Publike me nr. prot. 2713/1 e dt. 27.4.2021, me lëndë “Mbi procesin e ristrukturimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve”, AKAFPK u riorganizua. Për rrjedhojë, Sektori i Administratës, Financës dhe Teknologjisë së Informacionit (SAFTI), në 5 maj 2021 ndryshoi në strukturë, përbërje dhe emërtim.

Me ristrukturimin e institucionit, u krijua Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Projekteve, i cili në mungesë të Përgjegjësit të sektorit dhe mungesën e 4 anëtarëve të stafit përbërës së tij ka punuar në vështirësi duke përballuar volumin e punës së aktiviteteve institucionale krahas vështirësisë së pandemisë Covid-19.

Sektori është mbështetur në planin e punës së AKAFPK-së, planin e punës të sektorit, si dhe objektivat e tyre.

1. Zbatimi i të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar për nëpunësin civil mbetet pikë kyçe në krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike. Departamenti i Administratës Publike (DAP), si institucioni publik, qendror, përgjegjës për menaxhimin, mbikëqyrjen e shërbimit civil në të gjitha institucionet e administratës qendrore, ka bashkëpunuar me AKAFPK në procesin e ristrukturimit të institucionit, në procesin e sistemimit të punonjësve ekzistues, nëpunës civilë, të cilët u ripozicionuan në strukturën e re në zbatim të ligjit të sipërcituar. Gjithashtu, janë shpallur pozicionet e reja vakante në përputhje me Strukturën e re të AKAFPK. Si rrjedhojë e konkurrimit për pozicionet vakante të AKAFPK-së në lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë apo konkurrim nga jashtë shërbimit civil janë plotësuar 8 pozicione pune: 2 drejtorë drejtorie, 3 përgjegjës sektori si dhe 3 specialistë. Sektori ka zbatuar me përpikmëri udhëzime e marra nga DAP apo ka ndjekur trajnimet online në ndihmë të konsolidimit dhe mirëfunksionimit të regjistrit elektronik HRMIS (Human Resources Management Information System), sistemin e menaxhimit të regjistrit të punonjësve të Administratës Publike. Në përputhje me udhëzimet periodike të DAP-it, nëpunësi i AKAFPK-së, që merrej me burimet njerëzore ka punuar në plotësimin e regjistrit HRMIS me të dhënat kryesore të punonjësve të AKAFPK-së duke shtuar në dosjet elektronike dhe fizike punonjësit e rinj apo duke rifreskuar të dhënat e punonjësve ekzistues. Gjenerimi i pagave në Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SMIBNJ/HRMIS) është realizuar çdo muaj të vitit 2021 nga nëpunësi zbatues i AKAFPK-së.
2. AKAFPK përfaqësohet nga faqja elektronike zyrtare me adresë: ëëë.akafp.gov.al. Kjo faqe është aktive dhe përditësohet me veprimtari e njoftime të ndryshimet për t'i ardhur në

ndihmë bashkëpunëtorëve shqiptarë apo të huaj, të interesuar në realizimin e produkteve në fushën e AFP-së. Në rritje të transparencës, është publikuar, gjithashtu, mënyra e funksionimit të institucionit, mënyra e financimit të tij, e organizimit, struktura, adresa e institucionit, numrat e kontaktit si dhe adresa elektronike. Gjithashtu, në këtë faqe elektronike pasqyrohen veprimtaritë e projekteve të AKAFPK-së në kuadër të Programit “ERASMUS + dhe EASI. Sektori, veç rolit kryesor në përditësimin e ëeb-it të AKAFPK-së, ka administruar dhe mirëmbajtur rrjetin kompjuterik të institucionit.

3. Në kuadër të përmirësimit të komunikimit të brendshëm në platformën elektronike “Ëhatsapp”, rekomanduar nga MFE, për të lehtësuar shpërndarjen e informacionit në kohë reale për të gjithë punonjësit e MFE dhe të institucioneve të saj të varësisë, AKAFPK nëpërmjet grupit të punonjësve të saj, ka shkëmbyer informacione në shërbim të objektivave institucionale duke evidentuar aktivitetet më të rëndësishme.
4. Në bazë të ligjit nr. Nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, Rregullores mbi “Normat tekniko–profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” si dhe VKM nr. 1151 datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2021, në njësitë e qeverisjes qendrore”, duke qenë se në organikën e AKAFPK-së nuk ka pasur punonjës me detyrën e arkiv-protokollit, u rekrutua një punonjës me kontratë të përkohshme 1-vjeçare, punonjës nga jashtë shërbimit civil, i cili ka kryer protokollimin e dokumentacionit zyrtar. Lidhur me sa më sipër janë protokolluar dokumentet e vitit 2021 si edhe janë realizuar regjistrimet elektronike të tyre në funksion të mirë menaxhimit të dokumentit zyrtar të AKAFPK-së.
5. Programi i transparencës përcakton kornizën e veprimtarisë së institucionit, në kuadër të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe është i pasqyruara në faqen zyrtare elektronike të AKAFPK-së, në adresën: <http://ëëë.akafp.gov.al/rreth-nesh/programi>. Krahas punës periodike në administrimin e dokumentacionit zyrtar elektronik e fizik të AKAFPK-së, në përputhje me procedurat administrative të Institucionit si edhe legjislacionit aktual, sektori ka kontribuar në hartimin e programit të transparencës së AKAFPK-së si edhe në rifreskimin e vazhdueshëm të tij.
Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në zbatim të Urdhrit nr.187 datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të rishikuar” dhe Urdhrit nr. 188, datë 18/12/2020 "Për miratimin e Regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuar" organizoi në mars 2021 një prezantim online të Programit të Rishikuar të Transparencës dhe të Regjistrimit të Kërkesave dhe Përgjigjeve të Rishikuar.
6. AKAFPK, në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor të saj, në zbatim të Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 21, datë 9.7.2015 “Për procedurat e transferimit të nxënësve nga një nivel/drejtim i arsimit profesional në gjimnaz, në zbatim të “Rregullores së brendshme të AKAFPK-së për procedurat e transferimit të nxënësve shqiptarë ose të huaj, të cilët transferojnë studimet nga shkollat profesionale jashtë shtetit në shkollat profesionale në Shqipëri - procedura e njëvlershmërisë së studimeve të kryera” ka ndihmuar në procesin në çështje administrative. Në bashkëpunim me komisionin përkatës, sektori ka kontribuar në shqyrtimin e rasteve të paraqitura pranë AKAFPK-së në përputhje me legjislacionin në fuqi.
7. AKAFPK-ja është njësi koordinuese dhe përgjegjëse për zbatimin e Platformës Evropiane për Arsimin e të Rriturve (EPALE). Në kuadër të kësaj platforme AKAFPK ka zbatuar projektin EPALE NSS 2021. Në këtë projekt, sektori ka dhënë kontributin e anëtarëve të tij në zbatim të objektivave të projektit dhe në përputhje me marrëveshjet përkatëse. Janë realizuar seminarët e Javës së të Nxënësve gjatë Gjithë Jetës” në Vlorë, Gjirokastrë e Korçë,

takime rajonale në Elbasan, Himare e Shkodër, si dhe është prezantuar platforma EPALE ne Lezhe.

Veç kësaj, sektori ka kontribuar në hartimin e disa dokumenteve të nevojshme për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë(MFE).

8. Po kështu, sektori ka dhënë kontribut në dy projektet e tjera të AKAFPK-së si: “FORËORK-Fostering Opportunities of Refugee Eorkers” si edhe “National Coordinators for the Implementation of the European Agenda”, me hartimin e dokumentacionit të nevojshëm për rekrutimin e bashkëpunëtorëve të projekteve, me korrespondencat zyrtare midis Institucionit dhe MFE si dhe ka kontribuar në zbatimin e aktivitete të këtyre projekteve.
9. Në mbështetje Programi IPA të Bashkimit Evropian për Shqipërinë, projektit i BE “Asistenca Teknike për të Mbështetur Reformën mbi Politikat e Punësimit, Arsimit dhe Formimit Profesional” ofron mbështetje të institucioneve përgjegjëse për AFP-në në funksion të zbatimit të ligjislacionit, si dhe zhvillimit të planifikimit dhe zbatimit të mekanizmave mbështetëse në fushën e AFP-së. AKAFPK, si institucion përgjegjës për AFP-në ka kontribuar në takime me ekspertët e BE si dhe ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme në zbatim të këtij projekti.
10. Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 155, datë 24.11.2020 “Për Miratimin e Strukturës së Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve”, është punuar ngushtë me drejtorin e AKAFPK-së lidhur me rishikimin e përshkrimeve të punës për pozicionet e punës të krijuara nga riorganizimi i këtij institucioni dhe në përputhje me objektivat e institucionit të riformuar. Gjithashtu, në mbështetje të këtij riorganizimi është dhënë ndihmesë në përgatitjen e draft-rregullores së re, të brendshme për organizimin dhe funksionimin e AKAFPK-së.
11. Për vitin buxhetor 2021, AKAFPK filloi aktivitetet e saj në janar 2021 me një buxhet të përgjithshëm prej 65,218,000 lekë, të ndryshuar më pas në 49,830,000 lekë të miratuar nga MFE për artikullin 600, 601 dhe 602. AKAFPK për vitin 2021 ka realizuar aktivitetet e planifikuara sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela përmbledhëse e shpenzimeve të buxhetit të miratuar nga MFE dhe realizuar nga AKAFPK sipas planit për vitin 2021

KODI I PROJEKTIT	Artikulli	Plani i çelur	Plani i ndryshuar	Fakti
91011AD	600	11,007,000	10,484,000	9,837,010
91011AE	600	8,660,000	2,726,000	2,539,263
91011AF	600	6,067,000	1,331,000	658,668
91011AI	600	2,275,000		
	SHUMA	28,009,000	14,541,000	13,034,941
91011AD	601	1,838,000	1,759,000	1,758,613
91011AE	601	1,146,000	417,933	417,933
91011AF	601	1,013,000	182,067	
91011AI	601	412,000		
	SHUMA	4,409,000	2,359,000	2,176,546
91011AD	602	12,200,000	12,200,000	8,998,481
91011AE	602	11,300,000	11,300,000	3,783,312
91011AF	602	6,400,000	6,400,000	829,045

91011AI	602	2,900,000	2,900,000	247,672
	SHUMA	32,800,000	32,800,000	13,858,510
91011AA	602	-	130000	130000
BUXHETI GJITHSEJ	SHUMA	65,218,000	49,830,000	29,199,997

Grafiku i shpenzimeve të buxhetit të miratuar nga MFE dhe realizuar nga AKAFPK sipas planit për vitin 2021




Tabela përmbledhëse e shpenzimeve të buxhetit të projektit “EPALE National Support Services (NSS) for Albania” në llogaritë Lek dhe Euro.

Llogaritë e Projektit	Buxheti i çelur në janar 2021	Celur gjate vitit 2021	Buxheti gjithsej	Buxheti i realizuar 2021	Buxheti i mbetur
Llogaria në Lek	1,811,562	6,121,890	7933452	2,771,661	5,161,791
Llogaria në Euro	7,000.7		7,000.7		7,000.7

Tabela përmbledhëse e shpenzimeve të buxhetit të projektit “AGENDA” në llogaritë Lek dhe Euro

Llogaritë e Projektit	Buxheti i çelur në janar 2021	Buxheti i çelur gjate vitit 2021	Buxheti gjithsej	Buxheti i realizuar 2021	Buxheti i mbetur
Llogaria	1,062,743	352,500	1,415,243	1,179,577	235,666

në Lek					
Llogaria në Euro	3,520.7	- 3,000	520.7	3,000	520.7

Shënim: Nga llogaria në euro e këtij projekti, 3,000 euro kanë kaluar në llogarinë lek.

Tabela përmbledhëse e shpenzimeve të buxhetit të projektit “FORËORK” në llogaritë Lek dhe Euro

Llogaritë e Projektit	Buxheti i çelur në janar 2021	Buxheti i çelur gjatë vitit 2021	Buxheti gjithsej	Buxheti i realizuar 2021	Buxheti i mbetur
Llogaria në Lek	1,135,269	3,897,280	5,032,549	2,664,217	3,572,332
Llogaria në Euro	10,000	-10,000		0	

Shënim: Nga llogaria në euro e këtij projekti, 10,000 euro kanë kaluar në llogarinë lek.

Tabela përmbledhëse e buxhetit të mbetur nga projekti “Skemat e praktikës për punësimin e të rinjve në Shqipëri” në llogaritë Lek dhe Euro për vitin 2021, i cili është mbyllur.

Llogaritë e Projektit	Buxheti i çelur në janar 2021	Buxheti i çelur gjatë vitit 2021	Buxheti gjithsej	Buxheti i realizuar 2021	Buxheti i mbetur
Llogaria në Lek	26,161.92		26,161.92		26,161.92
Llogaria në Euro	25.94		25.94		25.94

12. Sektori ka bashkëpunuar me sektorët e AKAFPK-së dhe MFE për hartimin e Projekteve të Buxheteve Afatmesme dhe Afatgjata (PBA) të institucionit.
13. Në mbështetje të Ligjit nr. 9936 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave “Për përgatitjen e Programit Buxhetor 2022 –2024 sektorët e AKAFPK kanë bashkëpunuar në përgatitjen e këtij të fundit.
14. Në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar si edhe në zbatim të udhëzimit Nr.1, pika 7, datë 27.06.2014 “Për krijimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e strukturave të autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave, në institucionet publike”, Autoriteti Përgjegjës Teknik i AKAFPK-së (përgjegjësi i sektorit të AFTI) për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet publike ka raportuar periodikisht pranë ILDKPKI dhe ka dorëzuar për titullarët e AKAFPK-së formularët e plotësuar të deklarimit të interesave private të tyre. Gjithashtu, ka marrë pjesë në trajnimin mbi sistemin elektronik për deklarimin e pasurive dhe konfliktit të interesit (EACIDS)- Manuali i Autoriteteve përgjegjëse.

15. AKAFPK ka bashkëpunuar me MFE dhe SHKP lidhur me inspektimin e objektet shkollore mbi përmbushjen ose jo të standardeve normative nga ana e objektet shkollore, që aplikojnë për licencim pranë QKB-së.

Përgatiti:

Teuta Braço

AKAFPK

Tiranë, 12 janar 2022